



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:013874

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05499328

P.nr.572/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega në Viti-Departamenti i Përgjithshëm- duke vendosur sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Naser Maliqi, sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në çështjen penale të të akuzuarit L.Z, nga fshati K. Gjilan, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.59/23 të datës 13.01.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Huma Jetishi dhe i pandehuri i lartcekur, me datën 14.03.2024 shpalli, ndërsa me datën 22.03.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Ndaj të akuzuarit L.Z, nga babai H dhe nëna B, e lindur H, i lindur me datënnë Gjilan, me vendbanim neK. Gjilan, ka të kryer shkollën e mesme teknike, punon si automekanik, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal identifikues //, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTE FAJTOR

SEPSE

Me date 05.10.2022, rreth orës 15:30, ne territorin e..... Komuna e Vitise, ne vendin e quajtur "S...", i pandehuri ka vjedhë druj ne pyllin e pronës shtetërore, e administruar nga Agjensioni Pyjor Komunal ne Viti, ne atë mënyrë që me dashje dhe me qellim të përfitimit te kundërligjshëm për vehte, i njëjti ka prere me sharre motorike 287 copa drunj te llojit bung me diametër ne cung 10-12 cm, me lartësi te drurit 11 cm, me vëllim te përgjithshëm prej 4.02 m3, te cilat i ka bartur me traktor te markës "U..." dhe ne këtë mënyre Autoritetit Pyjor Komunal ne Viti i ka shkaktua dëm në vlerë prej 514 euro.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

-Andaj në bazë të nenit 4,38,39,40,43, 46,47,48,49,51,69,70,71 dhe 72 të KPRK-se dhe nenit 364, 449 te KPPK-se,

E GJYKON

Me dënim me gjobë ne lartsi prej **300,00 (treqinde) euro**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet me **kusht**, nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara Autoriteti Pyjor i Kosoves zyra ne Viti, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet ne kontest civil- juridik.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit L.Z, nga..... Viti, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me datën 14.03.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurores së shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën e lexuar dhe se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, duke kërkuar falje dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris veprën penale.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe publik gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të akuzuarit dhe prokurorit, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë, për shkak se ky pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit shtetëror me vlerësim dhe llogaritjen e demit ne pyll nr. 159/22 e dates 05.10.2022 e lëshuar nga APK Zyra ne Viti, fletëparaqitja e rojës se pyllit S.M me nr. 4/37/2022 te ditarit te rojës se pyllit, vlerësimi dhe llogaritja e demit te pyllit date 28.10.2022.

Fjala përfundimtare:

Prokurorja e shtetit Huma Jetishi ka mbetur në tërsi pranë aktit akuzues, duke kërkuar nga gjykata që gjatë marrjes së vendimit të ketë parasysht të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese për të akuzuarin.

I akuzuari L.Z ka kërkuar nga gjykata një dënim sa më të butë, duke premtuar se veprën nuk do ta përsërisë veprën, duke theksuar se kjo është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështet

në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se e njëjta nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka marr për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, ka pas parasysh pranimin e fajësisë, është penduar, ka kërkuar falje për kryerjen e kësaj vepre penale, i premtion gjykatës që në të ardhmen, nuk do të përsërisë vepra të tilla dhe të tjera penale, po ashtu si rrethanë lehtësuese për të pandehurin mori edhe rrethanat personale të tij për faktin se për të njëjtin ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin përkatësisht më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale. ndërsa rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori faktin se ka shkaktuar edhe dëm ekologjik.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPRK-ës, gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprës penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligj. Me rastin e kushtëzimit të dënimit me burgim gjykata mori parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht siç parashihet në nenin 47 të KPRK-ës i cili ka të bëjë me moszbatimin e dënimit me efektiv kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që kryesi të mos kryejë vepra të tjera penale gjithnjë duke pasur parasysh edhe faktin se plotësohen kushtet nga neni 49 i KPRK-ës për shqiptimin e dënimit të tillë.

E dëmtuara APK zyra ne Viti, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet ne kontest civil juridik.

Gjykata ka detyruar të pandehurin që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
Më datë 22.03.2024

Sekretarja Juridike;
Kadrije Zymberi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Naser Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura mundën të ushtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.